



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Karburanti për ngrohjen e sallave të leksioneve për
njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

09134000-7 - Naftë, 44115220-7 - Materiale ngrohje

VLERA E FONDIT LIMIT: 4,703,578.223 (katër milion e shtatëqind e tre mijë e pesëqindë e shtatëdhjetë e tetë pikë dyqindë e njëzetë e tre) **Lekë pa TVSH,**

3,114,048.223 (tre milion e njëqind e katërbëdhjetë mijë e dyzetë e tetë pikë dyqindë e njëzetë e tre) **lekë pa tvsh** për Fakultetin e Mjekësisë, Tiranë.

1,598,530 (një milion e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e tridhjetë) **lekë pa tvsh** për Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar VENDIM Nr. 498, datë 1.8.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave, autoriteti/enti kontraktor **Universiteti i Mjekësisë, Tiranë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të kualifikimit për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i

ndryshuar VENDIM Nr. 498, datë 1.8.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Subjekti duhet të paraqesë licencë për tregtimin me shumicë (VIII.1.A) ose tregëtimin me pakicë të karburanteve për përdorim nga konsumatorët fundorë, për lëndën djegëse sipas objektit të prokurimit, të lëshuar nga organet kompetente.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 40, pika 5, gërma a) e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në zbatim të ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, të VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës dhe nënprodukteve të saj”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.2.Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2020, 2021,2023) të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”.

2.3 Aftësitë teknike:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më pak se 20% të fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë;

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

b) Për furnizime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

a- Lejen e mjedisit sipas legjislacionit në fuqi për mjedisin, lëshuar nga QKL;

b- Vërtetim Teknik lëshuar nga ISHTI / nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK);

c- Çertifikatë e mbrotjes nga zjarri/Akt teknik lëshuar nga MZSH;

d- Policë sigurimi lëshuar nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për distributorët e shitjes me pakicë,

(të gjitha dokumentat duhet të jenë brenda afatit të vlefshmërisë datën e hapjes së ofertave).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, në ligjin nr. 32/2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të

pajisjeve dhe instalimeve nën presion". Në lidhje me kriterin e lejes mjedisore kjo kërkesë është referuar ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, i ndryshuar me ligjin nr. 60/2014 "Për një ndryshim në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 152 date 21.12.2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin", të ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me kërkesat mjedisore duke garantuar reduktimin, minimizimin apo shmangin e ndikimeve në mjedis të instalimeve ndotëse, duke respektuar standartet kombëtare. Akti teknik lëshuar nga MZSH është i rëndësishëm, pasi tregon që operatori ekonomik ofertues ka marrë masa dhe vepron në përputhje me legjislacion Shqiptar.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë në pronësi të vet ose me qira të paktën 2 (dy) automjete transporti autobot karburanti me kapacitet 1,000-5,000 litra, e vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontratë noteriale ose akt pronësie ose të jene të pasqyruara në ekstraktin e QKR, etj). Për këtë duhet të paraqesi librezë qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjeteve, çertifikaten për transportin e lëndëve të rrezikshme dhe pashaportën e mjetit për kapacitetin mbajtës në litra.

Shënim: Ky kriter (2.3.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar me Ligjin 16/2024 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 "Per prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 5/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 "Për transportet rrugore" (të ndryshuar), Udhëzimi Nr.15, datë 24.7.2007 "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor" me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate janë furnizimi dhe shpërndarja e mallrave objekt prokurimi në objekte të shpërndara në disa godina te ndryshme, automjetet e mësipërme konsiderohen të domosdoshëm pasi duke marrë në konsideratë natyrën dhe kohëzgjatjen e saj dhe vendodhjen e objekteve në të cilat do të kryhen furnizimet, i shërben Autoritetit Kontraktor për t'u bindur me kapacitetet teknike të ofertuesve me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë edhe deklaratat si më poshtë:

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë në bazë të së cilës merr përsipër furnizimin me karburante me botet e tij dhe shpenzimet e tij deri në vendin ku ndodhen depozitat e autoriteteve kontraktore përfituese.

- Operatori ekonomik duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin me bot me shërbim 24 orë, sipas kërkesave të autoriteteve kontraktore.

Argumentimi: Deklaratat i japin garanci Autoritetit Kontraktor për përmbushjen me sukses të objektit të prokurimit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i punës për përcaktimin e specifikimeve teknike i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e fondit limit me nr. 2695 prot., datë 15.10.2024 në përputhje me nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Specifikimet teknike janë hartuar bazuar në kërkesat e njëjësive shpenzuese, procedurave të mëparshme dhe referuar Standarteve Shqiptare.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJËSIA E PROKURIMIT: